

Funksionet dhe detyrat e gjykatës.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pjesa e nëntë titulluar “Gjykatat” neni 135:

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.....

Gjykata e Apelit Vlore shqyrton çështjet gjyqësore të ardhura nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Vlore, Lushnje Fier dhe Berat në bazë të ankimit të njëjës apo disa palëve.

Dosja e çështjes gjyqësore në momentin e ardhjes në Gjykatën e Apelit Vlore regjistrohet nga nëpunësi që ka për detyrë regjistrimin e çështjeve në sistemin përkatës elektronik (ICMIS) dhe me plotësimin e të dhënave (informacioni mbi çështjen, baza ligjore, palët ndërgjyqëse, vendimet e mëparshme të dhëna nga gjykatat, etj.) sistemi i vendos çështjes automatikisht një numër. Në zbatim të urdhërave të Kryetarit të Gjykatës mbi mënyrën e shortimit elektronik të dosjeve gjyqësore në gjykata, dosja hidhet për short, duke i kaluar gjyqtarit/relator. Ky short është elektronik dhe nuk mund të bëhen modifikime apo ndërhyrje në të.

Kur çështja kalon për gjykim, njoftimi për datën dhe orën e gjykimit bëhet nga Gjykata e Apelit duke e afishuar këtë njoftim tek stendat e lajmërimeve që janë në hyrje të Gjykatës së Apelit. Kjo shpallje vendoset edhe në stendat e lajmërimeve të Gjykatave përkatëse të rrethit (konkretish para gjykatës së rrethit e cila ka dhënë vendimin). Për raste të parashikuara në ligjet procedurale për çështje të caktuara, gjyqtarit mund të vlerësojë edhe thirrjen e palëve në gjykim nga sekretaria gjyqësore.

Në Gjykatën e Apelit Vlore çështjet gjykohen nga një trup gjykues, të përbërë prej 3 gjyqtarësh, me përjashtim të raste për të cilat ligji parashikon edhe gjykimin nga 1 gjyqtar i vetëm.

Pas dhënies së vendimit nga ana e gjykatës së apelit, nëse palët nuk janë dakort, mund të bëjnë rekurs në Gjykatën e Lartë Tiranë, brenda një afati të percaktuar ligjor. Afati i rekursit për çështjet civile është 30 ditë dhe afati i rekursit për çështjet penale është 45 ditë.

Ky rekurs duhet të depozitohet, pranë Gjykatës së Apelit Vlore, e cila pas ezaurimit të veprimeve administrative me dosjen gjyqësore përcjell nëpërmjet shërbimit postar dosjet gjyqësore pranë Gjykatës së Lartë ose sipas rastit nëse nuk është ushtruar rekurs në gjykatat e rretheve përkatëse.

Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor gjykata ndihmohet nga administrata gjyqësore, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse.

Gjatë veprimtarisë gjyqësore, gjyqtarët e gjykatës asistohen nga administrata gjyqësore e cila përmbush veprimtarinë e saj sipas ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Administrata gjyqësore kryen detyrat e saj në përputhje me ligjet procedurale në fuqi dhe aktet ligjore e nënligjore të nxjerra për këtë qëllim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë.

Vizioni i Gjykatës së Apelit Vlore

Dhënia e drejtësisë dhe trajtimi i publikut në mënyrë të drejtë dhe të barabartë sipas ligjit dhe dhënia e një impakti të drejtë për qytetarët në mënyrë që të kontribuojë në rritjen e besimit se ato do të trajtohen nga një sistem gjyqësor i pavarur, transparent, etik dhe efikas.

Misioni i Gjykatës së Apelit Vlore

Misioni i Gjykatës së Apelit Vlore mbështetet mbi një praktikë të mirë të punës së gjyqtarëve të gjykatës në gjykimin e çështjeve gjyqësore dhe përmirësimi i cilësisë së gjykimit është një sfidë për punën në gjykatë. Është detyra e misioni jonë që ta përmbushim atë duke krijuar identitetin e një institucioni gjyqësor efikas, transparent dhe të besueshëm për publikun.

Ky mision shkon përkrah misionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor i cili mbështetet në një sistem gjyqësor të pavarur që gjithmonë përpiqet të bëjë drejtësi, në një sistem të ndershëm gjyqësor që vepron në përputhje me parimet më të larta morale, etike dhe profesionale të gjyqtarëve, në një sistem gjyqësor të aksesueshëm dhe transparent për publikun dhe në një sistem gjyqësor ku të gjithë qytetarët janë dhe trajtohen si të barabartë përpara ligjit.